



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, me 30.06.2023

SHPLLJE VENDIMI

Drejtur : Bashkise Maliq

Për: Eleni Bezati dhe Zhylyen Bezati
Me adrese: Fshati Podgorie Bashkia Maliq

Bashkalidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 392 dt. 26.05.2022 për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi dëftesat e komunikimit janë kthyer me shënimin : " Larguar..." dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot ne datë -----
Per Bashkine Maliq

(emër, mbiemër, firmë)

Nr. 78 Prot

- Pj. A. Vreshtas
- STAMP
07.05.07.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Nr.Regj. 21001-00640-41-2023 (1043)
Datë regjistrimi 28.04.2023

Nr.Vendimi 41-2023-1630 (392)
Datë Vendimi 26.05.2023

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përbërë prej:

Gjyqtare Luljeta KOLE

Sot në date 26.05.2023, ora 11.30, bazuar në nenin 158 e 158/a të K.Pr.Civile pasi bëri në dhome keshillimi studimin e çështjes civile me nr. regj. them. 21001-00640-41-2023 (1043) date regjistrimi 28.04.2023 që i perket:

PADITËSE: **Eleni Bezati**, e bija e Valent dhe Loreta, i datelindjes 02.07.1998, lindur dhe banuese në Podgorie, Bashkia Maliq, njoftimi tek av.Nevzat Tarelli.

I PADITUR: **Zhylljen Bezati**, i biri i Dhiogjen dhe Burbuqe, i datelindjes 22.08.1993, lindur dhe banues në Podgorie, Bashkia Maliq.

OBJEKTI: Zgjidhje martesë dhe rregullimi i pasojave që rrjedhin prej saj

Baza ligjore: Neni 132 e vijues i K.Familjes

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesepadine dhe aktet bashkelidhur saj,

V Ë R E N

Paditësja Eleni Bezati ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë kërkesëpadinë me objekt zgjidhjen e martesës me të paditurin Zhylljen Bezati, si dhe rregullimin e pasojave pas zgjidhjes së saj, mbështetur në nenin 132 e vijues të Kodit të Familjes.

Kjo kërkesepadi, pasi është paraqitur është regjistruar me nr. regjistri themeltar 21001-00640-41-2023 (1043) dhe date regjistrimi 28.04.2023.

Gjate studimit paraprak të akteve, gjykata kryesisht konstaton se ndodhet para një prej rasteve kur duhet të vendose pushimin e gjykimit të kesaj çështje.

Me konkretisht, Gjykata u njoh me faktin se e njëjta kerkesejadi me objekt zgjidhje martesë ndërmjet këtyre paleve, ishte paraqitur më parë nga ana e shtetasit Zhylljen Bezati në cilësinë e paditësit, kundër Eleni Bezati në cilësinë e të paditëses.

Kjo kerkesejadi është regjistruar në datë 08.07.2022, ka numër çështje 21001-1091-41-2022 (1121), dhe është duke u gjykuar nga gjyqtare Eglantina Mikani.

Nga sa më sipër, gjykata cmon se jemi në kushtet e nenit 58 të K.Pr.Civile, në të cilin parashikohet se *"Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë"*.

Në këto rrethana, gjykata referuarparashikimit të kësaj dispozite, cmon se në këto rast duhet të vendose pushimin e gjykimit të çështjes për këto shkak.

Kurse në nenin 158/a të K.Pr.Civile që bën fjalë për vendimet e gjyqtarit gjatë veprimeve paraprake, përcaktohet se *"...2. Gjyqtari me vendim, pa caktuar seance përparimtare, kryen këto veprime: ...e) vendos për pushimin e gjykimit kur janë rastet e parashikuara nga neni 299 i këtij Kodi..."*

Shpenzimet gjyqësore të këtij gjykimi përbehen nga taksa mbi aktet në masën 3000 leke, të parapaguara nga paditësjatë. Në veshtrim të nenit 106 e vijues të K.Pr.Civile, këto shpenzime mbeten në ngarkim të paditëses.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 58, 299/ç e 158/a të K.Pr.Civile

VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit të çështjes civile me paditëse Eleni Bezati, i paditur Zhylljen Bezati, Objekti: Zgjidhje martesë etj, për shkak se e njëjta çështje e regjistruar më parë është në gjykim.
2. Shpenzimet gjyqësore në masën 3.000 lekë mbeten në ngarkim të paditëses.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm brenda 5 ditëve nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Korçë, më 26.05.2023 ora 11:45



GJYQTARE
LULJETA KOLE